



Pranimi / Dorezimi Prilbim / Prilbim Received / Delivery	08.03.2022	2	viti god year
Organi / Njësia Organi / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKËMBË	1244/2022		112



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.153/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.153/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit/Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.153/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] nga Kamenica.

### A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Komunën e Kamenicës, me datë 23.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 938/2022 të regjistruar me numër A.nr.153/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos përfshirjen e të njëjtës në listën e pagave nga data 03.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 938/2022 të regjistruar me numër A.nr.153/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 01.02.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 01.02.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 02.02.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 09.02.2022 nga ankuesja; Vendimin e datës 28.08.2019; Akt Emërimit e datës 06.08.2019; Kërkesë e datës 25.02.2022 për tërheqje të ankesës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesën me numër A.nr.153/2022 të datës 23.02.2022, **sepse:**

Ankuesja, me datë 23.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se e njëjta nga data 03.12.2021 nuk është përfshirë në listën e pagave të nëpunësve civil të Komunës së Kamenicës.

Kolegji, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja me datë 25.02.2022 përmes e-mailit zyrtar ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës duke theksuar se: "Përmes kësaj shkresa unë [redacted] si parashtruese e Ankesës e pranuar në KPM SHCK me Nr.Prot. 938/2022 dt.23.02.2022, ju njoftoj se po tërhiqem nga kjo ankesë, pasi që është realizuar qëllimi për të cilin jam ankuar, respektivisht është përmbushur kërkesa ime nga Komuna e Kamenicës për realizimin e pagës. Prandaj, kërkoj nga KPM SHCK- Departamenti përkatës që të mos e procedoj më tutje ankesën e parashtruar nga unë në lidhje me këtë çështje".

Me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 103 paragrafi 1 përcaktohet se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë". Andaj, në kuptim të kësaj dispozite ligjore dhe duke marr parasysh kërkesën e datës 25.02.2022 të ankueses për tërheqje të ankesës, Kolegji konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën A.nr.153/2022 të datës 23.02.2022.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.153/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPM SHCK-së;

